



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 319 Prot.

Tiranë, më 07.03.2018

**V E N D I M**

Nr.10, Datë 07/03/2018

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË NJËSINË E VETËQEVERISJES VENDORE BASHKIA LUSHNJE DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E LIGJSHMËRISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes, nëpërmjet vendimit nr. 214, datë 25.10.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Lushnje dhe Divjakë”, Komisioneri ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Lushnje,

**VËREJ SE:**

Me vendimin nr. 214, datë 25.10.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Lushnje dhe Divjakë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Lushnje.

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 1728 prot., datë 25.10.2017, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 1728/1 prot., datë 25.10.2017, “*Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Bashkinë Lushnje*”, i është njoftuar Kryetarit të Bashkisë Lushnje.

Pas kësaj, me shkresën nr. 9963/1 prot., datë 12.1.2018 “*Kthim përgjigje*”, (protokolluar pranë Komisionerit me nr. 30 prot., datë 18.1.2018), institucioni ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me të gjitha gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Institucioni i mbikëqyrur e ka dërguar projektraportin të shoqëruar me një shkresë, në përmbajtjen e së cilës pretendohet se, në lidhje me konkluzionet e grupit të mbikëqyrjes për mospërfundimin e procedurave të deklarimit të statusit të punësimit, hartimin e përshkrimeve të punës dhe vlerësimin e rezultateve në punë, është reaguar duke i finalizuar këto pcedura. Por, projektraporti i nënshkruar dhe shkresa që e shoqëron atë, janë dërguar pa iu bashkëlidhur aktet administrative të nxjerra në këtë rast dhe në këto kushte, verifikimi i përmbushjes së këtyre detyrave, në zbatim të rekomandimeve të Komisionerit, do të jetë objekt i verifikimit të mëtejshëm, në vijim të procesit të mbikëqyrjes në këtë institucion, pas miratimit të raportit përfundimtar.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **V E N D O S A:**

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Lushnje, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për*

*nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Lushnje, që për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, të veprojë si më poshtë:

- Të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullohen pasojat, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin për punonjësit e evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit të nxjerrë nga titullari i institucionit:
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Komunitetin*”, akti nr. 11, dt. 16.2.2015.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Urban dhe Rural*”, akti nr. 59, dt. 18.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik*”, akti nr. 97, dt. 2.6.2017.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Zhvillimit Rural*”, akti nr. 40, dt. 8.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për menaxhimin e tokës bujqësore*”, akti nr. 184, dt. 11.5.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për ligjshmërinë*”, akti nr. 19, dt. 23.2.2017.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për ligjshmërinë*”, akti nr. 18, dt. 23.2.2017.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për pyjet*”, akti nr. 137, dt. 26.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për kullotat*”, akti nr. 106/1, dt. 7.7.2017.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për këshillim dhe asistencë në terren*”, akti nr. 183, dt. 9.5.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë veteriner*”, akti nr. 20, dt. 31.3.2014.

- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë veteriner*”, akti nr. 145, dt. 26.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për zhvillim urban*”, akti nr. 349, dt. 17.12.2015.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Arkitekt*”, akti nr. 313, dt. 3.12.2015.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike*”, akti nr. 77, dt. 27.7.2015.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për mjedisin*”, akti nr. 207, dt. 9.6.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për investimet*”, akti nr. 3, dt. 4.2.2015.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për PAK*”, akti nr. 44, dt. 11.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për shërbimet sociale në terren*”, akti nr. 242, dt. 4.8.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për shërbimet sociale në terren*”, akti nr. 91, dt. 21.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për shpenzimet*”, akti nr. 208/1, dt. 16.6.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Përgjegjës i Sektorit të regjistrimit dhe vlerësimit*”, akti nr. 106, dt. 16.10.2015.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për biznesin e vogël*”, akti nr. 27, dt. 23.2.2017.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për biznesin e madh*”, akti nr. 34, dt. 28.2.2017.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për taksat familjare dhe taksën e tokës bujqësore*”, akti nr. 21, dt. 23.2.2017.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për kontrollin dhe inspektimin*”, akti nr. 106, dt. 7.7.2017.

- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i nivelit të lartë për tregjet*”, akti nr. 344, dt. 7.12.2015.
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Drejtor i Drejtorisë Juridike*”, akti nr. 180, dt. 9.5.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Përgjegjës i Zyrë së prokurimeve*”, akti nr. 66, dt. 25.4.2017.
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i nivelit të lartë për prokurimet*”, akti nr. 178, dt. 3.5.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i nivelit të lartë për arkivën*”, akti nr. 102, dt. 16.10.2015.
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i nivelit të lartë për arkivin*”, akti nr. 226, dt. 19.7.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i nivelit të lartë për protokollin*”, akti nr. 231, dt. 20.7.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i nivelit të lartë për IT*”, akti nr. 108, dt. 16.10.2015.
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Inspektor i tatim-taksave*”, në Njësinë Administrative nr. 1, akti nr. 168, dt. 27.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Inspektor i ndihmës ekonomike*”, në Njësinë Administrative nr. 1, akti nr. 102/1, dt. 12.10.2015.
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Inspektor i tatim-taksave*”, në Njësinë Administrative nr. 2, akti nr. 21, dt. 16.2.2015.
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Inspektor i përgjithshëm dhe infrastrukturës*”, në Njësinë Administrative nr. 3, akti nr. 17, dt. 23.2.2017.
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Inspektor i përgjithshëm dhe infrastrukturës*”, në Njësinë Administrative nr. 4, akti nr. 49, dt. 27.2.2015.
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Inspektor i tatim-taksave/arkëtar*”, në Njësinë Administrative Allkaj, akti nr. 113, dt. 22.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Inspektor i tatim-taksave/arkëtar*”, në Njësinë Administrative Bubullimë, akti nr. 118, dt. 25.4.2016.

- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor i tatim-taksave*”, në Njësinë Administrative Bubullimë, akti nr. 177/1, dt. 5.5.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor i financës/arkiv/protokoll*”, në Njësinë Administrative Hysgjokaj, akti nr. 102, dt. 21.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor i tatim-taksave/arkëtar*”, në Njësinë Administrative Hysgjokaj, akti nr. 103, dt. 21.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK /protokoll/arkiv*”, në Njësinë Administrative Hysgjokaj, akti nr. 124, dt. 25.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK*”, në Njësinë Administrative Dushk, akti nr. 40, dt. 13.3.2017.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor i financës/arkiv/protokoll*”, në Njësinë Administrative Karbunarë, akti nr. 44, dt. 13.3.2017.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK*”, në Njësinë Administrative Karbunarë, akti nr. 67, dt. 19.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor i tatim-taksave/arkëtar*”, në Njësinë Administrative Ballagat, akti nr. 115, dt. 20.7.2017.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK*”, në Njësinë Administrative Ballagat, akti nr. 108, dt. 21.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor i financës/arkiv/protokoll*”, në Njësinë Administrative Fier Shegan, akti nr. 126, dt. 1.9.2015.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor i tatim-taksave/arkëtar*”, në Njësinë Administrative Kolonjë, akti nr. 171, dt. 27.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor i tatim-taksave/arkëtar*”, në Njësinë Administrative Krutje, akti nr. 101, dt. 21.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor i ndihmës ekonomike/PAK*”, në Njësinë Administrative Krutje, akti nr. 104, dt. 6.7.2017.
- Të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të akteve të konfirmimit si nëpunës civil dhe të rregullohen pasojat, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin për punonjësit e evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës, aktit të emërimit dhe aktit të konfirmimit:

- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për auditimin*”, akti i emërimit nr. 107, dt. 16.10.2015, akti i konfirmimit nr. 335, dt. 30.12.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për ligjshmërinë*”, akti i emërimit nr. 32, dt. 17.2.2015, akti i konfirmimit nr. 332, dt. 30.12.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Jurist*”, në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Komunitetin, akti i emërimit nr. 154/1, dt. 17.5.2016, akti i konfirmimit nr. 350, dt. 30.12.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Arkitekt*”, akti i emërimit nr. 4, dt. 4.2.2015, akti i konfirmimit nr. 334, dt. 30.12.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për strehimin*”, akti i emërimit nr. 33, dt. 17.2.2015, akti i konfirmimit nr. 339, dt. 30.12.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për mbrojtjen e fëmijëve*”, akti i emërimit nr. 18, dt. 16.2.2015, akti i konfirmimit nr. 337, dt. 30.12.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për PAK/ndihmë ekonomike dhe të ardhurat*”, akti i emërimit nr. 92, dt. 21.4.2016, akti i konfirmimit nr. 348, dt. 30.12.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Jurist*”, akti i emërimit nr. 76, dt. 3.6.2015, akti i konfirmimit nr. 331, dt. 30.12.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për asetet*”, akti i emërimit nr. 60, dt. 7.4.2015, akti i konfirmimit nr. 336, dt. 30.12.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për biznesin e vogël*”, akti i emërimit nr. 65, dt. 7.4.2015, akti i konfirmimit nr. 338, dt. 30.12.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për kontrollin dhe inspektimin*”, akti i emërimit nr. 28/1, dt. 27.2.2017, akti i konfirmimit nr. 347, dt. 30.12.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për mbledhjen e borxhit*”, akti i emërimit nr. 18, dt. 31.3.2014, akti i konfirmimit nr. 346, dt. 30.12.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për asistencën ligjore*”, akti i emërimit nr. 156/1, dt. 17.5.2016, akti i konfirmimit nr. 330, dt. 30.12.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist i nivelit të lartë për ligjshmërinë*”, akti i emërimit nr. 153/1, dt. 17.5.2016, akti i konfirmimit nr. 333, dt. 30.12.2016.

Njësia përgjegjëse, të planifikojë zhvillimin e kësaj procedure, me qëllim që ndërprerja e marrëdhënieve të punës, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke e ndarë procesin e rregullimit të ligjshmërisë në dy faza.

Njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2018, planin e punës së pranimeve në shërbimin civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira pas ekzekutimit të këtij vendimi, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga Komisioneri, duke mbajtur parasysh orientimet, në pikat më sipër të këtij vendimi.

Njësia përgjegjëse, të fillojë procesin e rekrutimit për pozicionet e lira në kuptim të ligjit, duke u kujdesur për përmbushjen e rregullave të përcaktuara në kreun IV, “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe duke u bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse (njësia e burimeve njerëzore), që të drejtojë procesin e hartimit të përshkrimeve të reja të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, në bashkëpunim me subjektet e tjera të ngarkuara me ligj (analisti i punës, eprori direkt dhe drejtori i përgjithshëm), sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, lidhjeve pjesë e këtij vendimi dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit.

Njësia përgjegjëse, të njoftojë të gjithë subjektet që ligji i ngarkon me administrimin e aspekteve të veçanta të shërbimit civil.



4. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse (*njësia e burimeve njerëzore*), në zbatim të përcaktimeve dhe procedurave specifike të parashikuara nga pika 3, 4 e 6, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 116, datë 5.3.2014 i Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të kryejë veprimet si më poshtë:

- ✓ Të finalizojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësit:
- \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*.

Në rastin e punonjësve që do të deklarohen “Nëpunës civil në periudhë prove”, njësia përgjegjëse të marrë masat për të zbatuar të gjitha detyrimet ligjore që parashikon ligji për nëpunësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit të detyrueshëm në ASPA; vlerësimin për periudhën e provës nga eprori; dhe pas kësaj, nxjerrjen e vendimit për konfirmimin, ose jo si nëpunës civil.

- ✓ Për punonjësit \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*  
njësia përgjegjëse të hartojë dhe miratojë përshkrimet e punës, për pozicionet përkatëse ku ata aktualisht kryejnë funksionet si pjesë e shërbimit civil dhe pas kësaj, të vendosë nëse këta punonjës, i plotësojnë ose jo kriteret për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me ligjin nr. 152/2013 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Nëse pas kësaj, do të rezultojë se punonjësit nuk i plotësojnë kërkesat e posaçme të pozicionit përkatës, atëherë të vijohet me ndërprerjen e marrëdhënies së punës me institucionin dhe plotësimin e pozicionit në përputhje me ligjin.

- ✓ Për punonjësit \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*  
të vendoset përfundimi i marrëdhënies së punësimit me pozicionin përkatës të shërbimit civil, duke evidentuar faktin se këta punonjës nuk zotërojnë një diplomë të arsimit të lartë “*Master Shkencor*”/“*Master Profesional*”/“*Bachelor*”, ndërkohë që ky është një kusht i domosdoshëm i parashikuar nga VKM nr. 142, dt. 12.3.2014 “Për përshkrimin

*dhe Klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, lidhja nr. 2, ndarja 2/2 “Përshkrimi i përgjithshëm i punës dhe kërkesat për pranimin në çdo klasë”, si dhe akti nënligjor për pagat.*

5. Për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me rastet e ngritjes në detyrë në kundërshtim me ligjin, Kryetari i Bashkisë Lushnje të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për secilin punonjës të evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit të nxjerrë nga titullari i institucionit:

- ✓ \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Sektorit të menaxhimit të tokës bujqësore (kadastra)”, akti nr. 156, dt. 26.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Sektorit të veterinarisë dhe mbrojtjes së konsumatorit”, akti nr. 19, dt. 31.3.2014.
- ✓ \*\*\*\*\*, “Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore”, akti nr. 25, dt. 9.4.2014.
- ✓ \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Sektorit të kontrollit dhe inspektimit”, akti nr. 78, dt. 19.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Sektorit të urbanistikës”, akti nr. 104, dt. 16.10.2015.
- ✓ \*\*\*\*\*, “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse”, akti nr. 87, dt. 20.4.2016.

Punonjësit të rikthehen në pozicionet e mëparshme të punës. Në rastet e pamundësisë për t’u rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, të bëhet sistemimi në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori ku ata i plotësojnë kërkesat specifike për vendin e punës.

6. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, në respektim të procedurave të hollësishme të parashikuara në vendimin nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar dhe lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi, të përfundojë vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë, për 6 mujorin e dytë të vitit 2017, si dhe të ndjekë procesin në të ardhmen për realizimin e tij, brenda afateve.

Në përfundim të procesit, formulari i vlerësimit për çdo nëpunës civil, të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit, siç parashikohet në pikën 18, të kreut II, të aktit nënligjor si më sipër.

Të njoftohen të gjithë subjektet që kanë lidhje me këtë proces në rolin e zyrtarit raportues/zyrtarit kundërfirmues/zyrtarit autorizues.

7. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit të sistemojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2 pjesë e vendimit nr. 117, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes.
8. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dajeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
9. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Lushnje, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
10. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
11. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Lushnje, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**